

KONFERENCA VJETORE: NJË VIT I MUNDËSIVE TË REJA

SESIONI I PANELIT: POLITIKAT SOCIALE DHE SHËNDETËSORE NË KOHË KRIZE

Në kuadër të panelit të konferencës, e cila u mbajt në fund të muajit janar të këtij viti, e organizuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me titull "Viti i mundësive të reja". Në pjesën e katërt të panelit u prezantuan: ministri i shëndetësisë, Bekim Sali, ministrja e punës dhe politikës sociale, Jovanka Trençevska, Këshilltarja për shëndetësi e kryeministrit, Ana Daneva Markova, Masimiliano Paoluçi, Drejtor i Bankës Botërore në RMV, Koordinatorja e përhershme e OKB-së në RMV, Rosana Duxhiak dhe kryetarja e Lidhjes së të Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë, Stanka Trajkova, e cila theksoi, "Të respektuar. Në periudhën e kaluar gjatë pandemisë dhe tani në periudhën e paspandemisë, është siguruar pagesa e rregullt e pensionit dhe rregullimi aktual i pensionit. Sipas të dhënave të fundit, pensioni mesatar arrin në 15.520, dhe pjesëmarrja e pensionit mesatar në pagën mesatare për momentin është 53.07%. Dihet se ky raport është matës i vlerës së pensionit, pra nëse pensioni mesatar është nën 60%, është një "alarm" për marrjen e masave të duhura për përmirësimin e atij raporti. Burimi i të ardhurave që siguron pagesën e pensioneve varet nga të siguruarit aktivë që paguajnë kontribut, ra-



porti i cili është 1/2. Ndryshe, sipas të dhënave të publikuara, pensionet pritet të rriten me rreth 8%".

"Vlen të thuhet se LSHPM, si organizatë civile, për herë të parë në veprimtarinë e saj pati mundësinë të marrë pjesë në krijimin e metodologjisë së re, pra në mënyrën e re të harmonizimit të pensioneve me një pjesë të rritjes së pagave dhe shpenzimet, në përqindje të barabartë. Mirëpo, Lidhja vazhdoi të ndjekë metodologjinë e re për rregullimin e pensioneve pasi kjo ka të bëjë me masën e pensionit dhe Lidhja tashmë ka propozime të reja dhe propozimi për rregullimin e pensioneve nga 1 janari dhe 1 korriku i vitit aktual është veçanërisht i rëndësishëm dhe për këtë arsye, pensioni i rregulluar aktualisht do të paguhet për të gjithë 12 muajt.

Në këtë mënyrë do të tejkalohet problemi i krijimit të diferencave në nivelet e pensioneve mes pensionistëve që në vitin aktual përfitojnë pension në të njëjtat kushte. Ky propozim është i drejtë dhe korrekt dhe ne propozojmë që në ndryshimin e parë të Kodit Civil të ndryshohet neni i njohur 37. Për këto propozime Lidhja do të përgatisë edhe një propozim për formulim ligjor. Argumenti se pensionet të rregullohen nga 1 marsi dhe 1 shtatori për shkak të të dhënave për rritjen e kostos së jetesës dhe pagave nuk qëndron, dhe rregullimi aktual mund të paguhet si diferencë. Fokusi i Lidhjes është te pensionet e ulëta, pra një e dhënë shumë e rëndësishme është se pse ky numër është mjaft i madh dhe do të thosha se pensionet e ulëta gjenerohen nga vetë sistemi i

pensioneve dhe kontribuojnë edhe vetë punonjësit dhe të debatohet për këtë çështje është e nevojshme më shumë kohë. Besoj se edhe kjo do të ndodhë dhe vetëm shtoj se çështjet e punësimit apo sociale nuk duhet të zgjidhen përmes sistemit të pensioneve dhe nuk ka dyshim se duhet një fushatë mes të rinjve nga e cila varet pensioni i tyre, gjegjësisht anuiteti. Është fakt që të rinjtë mendojnë se pleqëria është larg por po vjen shpejt. Kur bëhet fjalë për mbrojtjen e pensionistëve si target grup i madh, përveç pagesës së pensionit, janë shumë të rëndësishme edhe masat që duhen marrë jashtë sistemit të pensioneve. Në këtë krizë të përkohshme të mbivendosjes - ekonomike, demografike, energjetike, pati edhe masa kundër krizës në të cilat u përfshinë

edhe pensionistët, veçanërisht ata me të ardhura më të ulëta pensionale dhe për kënaqësinë tonë, Lidhjes iu dha mundësia të merrte pjesë me propozimet e veta, duke kërkuar që ndihma të bëhet në 3 nivele - shteti, komuna dhe shoqatat e pensionistëve. Dihet që masat kundër krizës janë zgjidhje afatshkurtra, por pensionistët propozojnë edhe zgjidhje afatgjata, veçanërisht në fushën e sigurimeve shëndetësore, siç është nevoja për miratimin e një liste të re pozitive të barnave që nuk është përditësuar prej 15 vitesh, funksionimi i njëkohshëm i mjekut në terren dhe një farmacie e lëvizshme në zonat rurale, duke rritur kufirin, pra masën e pensionit për përjashtimin nga participimi në trajtimin spitalor, çështja e deficitit të hapësirës geriatrike, sepse vjen koha që personi i moshuar duhet të akomodohet atje.

Mos harroj të theksoj në këtë vit 2023 si vit i mundësive të reja, të mbështetet edhe ndërtimi i shtëpi-ve të pleqve që do të korrespondojnë me masën e pagesave të pensioneve, dhe kërkesa kryesore dhe domethënëse e pensionistëve është që të dorëzohen gradualisht objektet e ndërtuara të pensionistëve me mjetet e pensionistëve të Shoqatave të pensionistëve, sepse në ditët e sotme është utopi ndërtimi i objekteve të tilla për organizatat civile. Dhe me këtë rast do të them se lista e çështjeve është e gjatë dhe Lidhja, si përfaqësues legjitim i interesave të pensionistëve, do të vazhdojë të kërkojë, të riaktivizojë, domethënë jo se jemi të moshuar dhe harrojmë, por të arrihen ato subjekte që janë kompetente për ta zgjidhur atë çështje", ka theksuar Trajkova. Vasil Paçemski

ANGAZHIMI I QEVERISË PËR KUJDES KONKRET DHE TË PËRHERSHËM PËR STANDARDIN E PENSIONISTËVE

KRYEMINISTRI NË TAKIM ME KREUN E LSHPM

Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Dimitar Kovačevski, së bashku me ministren e punës dhe politikës sociale, Jovana Trençevska, më 11 janar të këtij viti, takuan kryetaren e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, Stanka Trajkova dhe përfaqësues të Lidhjes.

Kryeministri Kovačevski dhe ministrja Trençevska e mbajtën takimin në hapësirat e Lidhjes me qëllim të konfirmimit të përcaktimit të Qeverisë për kujdes specifik dhe të përhershëm për standardin e pensionistëve.

Në takim, kryetarja e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, Stanka Trajkova shprehu kënaqësinë për mbajtjen e këtij takimi të rëndësishëm si dhe për ndihmën dhe mbështetjen e madhe nga Qeveria dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale që u japin pensionistëve. Në prezantimin e saj konciz dhe elokuent, ajo veçoi vetëm tre çështje, pra problemet, si më të rëndësishmet për pensionistët në këtë moment, edhe pse siç tha ajo ka më shumë çështje që do të donte t'i trajtonte, por do të mbeten për një takim të ardhshëm të këtillë.

"Fillimisht dua të shpreh mirënjohjen dhe kënaqësinë tonë që edhe Qeveria edhe

MPPS tek LSHPM shohin një aktor aktiv në zgjidhjen e problemeve të pensionistëve. Krahas pagesës së rregullt dhe përshtatjes së rregullt sipas metodologjisë së re, shprehim mirënjohjen tonë që edhe në masat kundër krizës që u miratuan nuk u anashkalluan përfituesit e pensioneve. LSHPM, duke realizuar funksionimin e metodologjisë dhe mënyrën se si ajo reflekton në masën e pensionit dhe pagesën e të ardhurave nga pensionet, përgatiti propozime të reja për përmirësimin e mëtejshëm të formulës së harmonizimit të pensioneve. Propozohet që gjatë vitit të paguhet pensionet e shtuara për të gjitha 12 muajt e vitit. Me këtë do të arrihet një gjë më e rëndësishme, e cila është vënia e të gjithë pensionistëve që kanë të drejtë në pension në vitin aktual në pozitë të barabartë ligjore. Në këtë mënyrë nuk do të kishte dallime në nivelet e pensioneve që do të fitoheshin në të njëjtat kushte. Gjithashtu dua të theksoj kërkesën për krijimin e një baze ligjore për rregullimin degresiv të pensioneve, pra pensionet më të ulëta të rregullohen me përqindje më të lartë, por vetëm në periudha të veçanta. Problemi apo çështja e dytë e rëndësishme janë objektet e pensionistëve në shtet. LSHPM ka përgatitur informacion për gjendjen e këtyre objek-

teve në të cilat ka dhënë konkluzionet e veta. Konkluzioni i parë është miratimi i një Programi Kombëtar në nivel të Qeverisë, me të cilin në kuadër të ndryshimeve në Ligjin për Shoqatat dhe Fondacionet, do të gjendej zgjidhja për ndarjen e objekteve të pensionistëve në përdorim të përhershëm për shoqatat e pensionistëve, sepse besojmë se do të kujdesen më së miri për ta dhe janë ndërtuar me fondet e pensionistëve. Së treti, dua t'i shpreh mirënjohjen time Qeverisë që LSHPM mori statusin e subjektit me interes publik si një organizatë civile që ka mbijetuar dhe funksionuar për 75 vjet dhe është një aktor aktiv në shoqëri në disa sfera. Kjo është një njohje e një rëndësie të madhe për LSHPM, sepse LSHPM merr përfitime të dobishme me këtë", u shpreh Trajkova.

Të pranishmëve iu drejtua kryeministri Dimitar Kovačevski, i cili ndër të tjera tha, "Me këtë takim me kryesinë e LSHPM, unë dhe ministrja e punës dhe politikës sociale duam të konfirmojmë se vazhdojmë të kujdesemi për standardin e jetesës së pensionistëve në partneritet, përmes politikave sistematike dhe të përgjegjshme. Sa i përket kërkesës për objektet e pensionistëve kudo që kemi mundësi, të cilat janë në pronësi të



RMV dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore, do të ndihmojmë në zgjidhjen e problemeve. Për sa i përket marrjes së statusit të interesit publik të LSHPM, Lidhja e meriton atë si një subjekt i rëndësishëm dhe me interes strategjik për Qeverinë dhe shtetin".

Ministrja e punës dhe politikës sociale, Jovana Trençevska, duke iu drejtuar të pranishmëve tha se çdo gjë që është reale dhe e realizueshme, MPPS do të mundohet ta realizojë.

Më pas kryeministri dhe ministrja vizituan bibliotekën e pensionistëve. Në fund pati një konferencë për media ku kryeministri Kovačevski dhe kryetarja Trajkova para gazetarëve të pranishëm nga mediat elektronike dhe të shkruara deklaruan për çështjet e diskutuara në takim. ASK 60